# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-463133**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Falsifikimi i certifikatës së COVID, trajneri i Zvicrës për Xhakën: E ka kuptuar që ka bërë gabim! I bindur se do të gjejmë një zgjidhje për të gjithë |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/sport/falsifikimi-i-certifikates-se-vaksinimit-te-covid-trajneri-i-zvicres-per-x-i587984` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | redirected |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 23 shtator 2026, 18:56:54 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 23 shtator 2026, 19:05:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `d9980419a1e8ea04a2dc76247f3f3e7456e9cb2369bd22ec9b56c1731ca2e372` |
| TEKSTI | `cbda6e4fab13d1c920f6fe5a0b3c380a1fe404fcf8785f21493b3d162ba6afa1` |
| PAMJA | `5c5fedd58f798bb85edd0bdd921a0839937e78837de4d5b4c816044b4c25e7a2` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `c4994f12e0db51f783bfee376aa38016f4da9823c3459d522398561f4400f090` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/c4994f12e0db51f783bfee376aa38016f4da9823c3459d522398561f4400f090`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

English



# Falsifikimi i certifikatës së COVID, trajneri i Zvicrës për Xhakën: E ka kuptuar që ka bërë gabim! I bindur se do të gjejmë një zgjidhje për të gjithë

TemA
23 Shtator 2026, 21:05Sport TEMA



Trajneri i Zvicrës, Murat Yakin, ka folur për situatën e Granit Xhakës pas rastit të certifikatës së falsifikuar të vaksinimit gjatë pandemisë së COVID. Kapiteni zviceran e ka pranuar gabimin dhe, sipas Yakin, ka marrë publikisht përgjegjësinë për veprimet e tij.

"Graniti e ka kuptuar se ka bërë një gabim. Atij i vjen keq dhe publikisht e ka marrë përgjegjësinë", deklaroi Yakin për "Blick".

Xhaka ishte planifikuar të bashkohej me Zvicrën në Belek për përgatitjet e ndeshjeve të radhës. Megjithatë, pas bisedimeve me presidentin e SFV-së, Peter Knabel, ai vendosi të qëndrojë larg kombëtares për disa javë.

Vendimi synon të shmangë shpërqendrimin e ekipit nga debati publik rreth çështjes. Yakin pranoi se mungesa e mesfushorit është një humbje sportive për Zvicrën.

"Është sigurisht një keqardhje e madhe nga aspekti sportiv që duhet të bëj pa të", tha ai.

Megjithatë, trajneri zviceran beson se vendimi i marrë është i duhuri në këtë moment.

Për rikthimin e Xhakës në grumbullimin e ardhshëm, Yakin nuk ka dhënë një përgjigje përfundimtare. Situata pritet të diskutohet nga SFV-ja me kapitenin pas katër ndeshjeve të kombëtares.

"Jam i bindur se do të gjejmë një zgjidhje të mirë për të gjithë", theksoi Yakin.

Ai shtoi se është në kontakt të vazhdueshëm me Xhakën dhe vlerësoi qasjen e tij ndaj ekipit.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[“Do të largohem kur të mos më duan më”/ Ronaldo nuk ka ndërmend të tërhiqet: Kam dy objektiva, 1000 golat dhe...]

19:55 Sport

[Ofertë konkrete për Elseid Hysajn, Ascoli këmbëngul për mbrojtësin kuqezi]

17:55 Sport

[Gary Lineker: Refuzova të punoja me FIFA-n pasi më kërkuan të takohesha me Putin-in]

16:55 Sport / 2 komente

['Në Ligën e Kombeve për vendin e parë', Daku dhe Seferi thumb Sylvinho-s: Me Maran ndjehemi më të vlerësuar]

14:55 Sport / 6 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.